


*Projekt nga lënda e gjuhës
shqipe.*

Tema:Faik Konica.

*PUNOI:ADISA NUREDINI IX³
MENTORE:IGBALL MEMISHI*

Faik Konica

- ▶ U lind më 15 mars në vitin 1875 dhe vdiq Më 15 dhjetor të vitit 1942.
- ▶ Kombësia:shqipëtar.





Rrëfime rreth Konicës

- ▶ Faik Konica ka qenë figurë qëndrore e lëvizjes kombëtare, studiues i historisë dhe gjuhës shqipe, botues, publicist, drejtues i Vatrës dhe diplomat shqiptar. Ministri fuqiptotë i Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e përkohshmja e tij Albania ka qenë ndër tribunat e publicistikës shqiptare për trembëdhjetë vjet. Vetë Konica është i njohur për erudicionin, publicistikën, stilin dhe ndikimin që pati në kulturën dhe politikën shqiptare. Është po ashtu autor i dy romaneve të shkruar në gjuhën frënge me nofkën *Jean de Croia* (sq. *Gjoni i Krujës*), *Le mariage de Leila suivi de Sotiri et Mitka* (Martesa e Lejlës *pasuar nga Sotiri dhe Mitka*) botuar më 1911


Biografia


- ▶ U lind në Konicë, në oxhakun e bejlerëve të njohur si Zenelbejllinjë, i biri i Shahin beut dhe Zeliha hanëm Delvinës, i treti ndër katër djemtë, Mehmeti, Rustemi dhe Hilmiu.
- ▶ Mësimet e para i mori në vendlindje nga mësuesë privatë. Më 1883 vizitoi të motrën, Xheva hanëm që në atë kohë banonte në Shkodër. Ndoqi shkollën saveriane në dy vite shkollore 1883-1885 ku ndoqi lëndë në italisht, latinisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Kthehet në vendlindje për ndoshta një vitë dhe më pas vijoi shkollimin në Liceun Perandorak të Gallatasarajit në Stamboll gjatë viteve 1886-1887. Filloi studimet universitare më 1890 në Collège de Lisieux në Normandi; më 1893 ai shkoi në Lycée de Carcassonne në jug të Francës ku studioi deri më 1894, duke u përqëndruar në studimet klasike, letërsi dhe filozofi.

- 
- ▶ Më 1893, gjatë “Année du Rhétorique” doli studenti i parë i kursit në lëndën e kompozicionit në frëngjisht dhe në përkthimet latine. Përfundoi studimet universitare me diplomën of Bachelier de l’Enseignement Secondaire Classique (Lettres – Philosophie) në Fakultetin e Letërsisë të Dizhonit (Université de France) më 16 nëntor 1895, ku u pagëzua i krishterë katolik me emrin *Domenik*, që e ka përdorur edhe në një letërkëmbim “beg Faik - Dominik Koniza”.
 - ▶ Në vitet 1895-1896, Konica filloi studimet pasuniversitare tek Collège de France në Paris, ku u përqëndrua në “letërsinë





► Në 1897 shkoi në Bruksel ku themeloi të përkohshmen *Albania*, me ndihmën e autoriteteve austro-hungareze. Sipas dokumenteve belge, gjatë kohës që jetoi në Francë, Konica kish njohur Sophie Annette Hugon, me të cilën, në 1897, pati një djalë të quajtur Henrik. Më 1903 u shpërngul në Londër, ku mori leje të punonte në Departamentin e Dorëshkrimeve të Muzeumit Britanik. Në Londër jetoi pesë vjet dhe studioi dokumentet shtetërore veneciane që lidheshin me Shqipërinë si dhe me dorëshkrime të tjera, disa prej të cilave i botoi tek “Albania”. Në 1909 u ftua prej shqiptaro-amerikanëve të shkonte në Shtetet e Bashkuara, ku të jepte një varg leksionesh, që e bëri në dyvjeçarin 1909-1911. Më 22 tetor 1909 mori në dorëzim prej Fan Nolit redaksinë e Diellit, botim javor i Shoqërisë "Besa-Besë". Konica punoi si kryeredaktor i Diellit deri më 18 mars 1910, për t’u kthyer sërish me 6 maj deri me 1 korrik 1910 dhe mandej prej 1 gushtit 1912 deri më 8 korrik 1913. Më 24 dhjetor 1911 në një mbledhje drejtuar nga Kristo Floqi, Konica caktohet anëtar i Komisionit për


- 
- ▶ Më 14 mars 1912 u regjistrua pranë Zyrës së Emërimeve të Universitetit të Harvardit, pra gjatë semestrit të dytë të vitit shkollor. Në arkivin e tij privat më 13 mars 2006 iu gjet kërkesa për punësim, përmes së cilës mëtonte të punësohej si *“pedagog në kolegji, shkollë normale ose shkollë tetëvjeçare; në lëndët: gjuhë romane, kryesisht frëngjisht dhe italisht”*. Pyetjes se në cilat pjesë të SH.B.A.-së dëshironte të punonte, ai iu përgjigj: “Në 1912-1913, në rrethinat e Cambridge-it; në vitet e mëpasme kudo”. Sipas studiuesit Alibali synimi i tij për të mos u larguar nga Bostoni në një periudhë kritike të lëvizjes shqiptare në Amerikë përkon edhe me veprimtarinë e ethshme të Konicës e Nolit gjatë këtyre dy viteve në kuadrin e Vatrës. Fakti që formulari i punësimit është gjetur në arkivën private të Faikut dhe jo në arkivën e universitetit tregon se Konica nuk e dorëzoi atë tek zyra përkatëse. Sipas Kastratit, Konicës iu ofrua në fund të studimeve një vend pune si pedagog

- 
- ▶ Në shtator të 1921, Faiku u kthye nga Napoli në Boston me ftesë të *Vatrës* për t'u bërë kryetar i saj. Konica nisi të kritikonte Zogun kur u emërua kryeministër më 1922 me pendën e tij të vrerosur. Më 1923 u takua në Boston me 20-vjeçarin Gjon Mili, të cilit do t'i ofronte miqësinë e tij. Pas takimit me mikun e vjetër Fazli Frashëri më 1925, Konica ndërroi qasje kundrejt Zogut duke u shprehur gjithnjë e më tepër si edukator përmes publicistikës së tij. Më 13 korrik 1926 dorëzoi letrat kredenciale si Ministër Fuqiplotë i Republikës në Departamentin e Shtetit Amerikan.

Konica me bashkëpunëtorët e tij në Boston



- 
- ▶ Në vitin 1926 Ahmet Zogu e emëroi Konicën ministër fuqiptotë në SHBA, post që e ushtroi deri në vitin 1939, kur Italia e pushtoi Shqipërinë. Pas kësaj u shfuqizua nga Qeveria Amerikane ngaqë delegata e diplomacisë shqiptare ishte zhytur në borxhe. Prish raportet përfundimisht me Ahmet Zogun, që i ristabilizon më 1942 në verë për çështjen shqiptare nën okupacionin italian. Vdiq më 15 dhjetor 1942 në Uashington, nga një hemorragji cerebrale. Trupi i tij u përcoll për në banesën e fundit nën tingujt e kompozitorit të famshëm Vagnerit, që aq shumë e kish

- 
- ▶ ***Ndërroj jetë me mejtimin se ju jeni njerëzit që më keni kuptuar më qartë në këtë dhe. Nuk do të më tretë dheu, nëse ti imzot Noli dhe ti Lamja im i vogël dhe gjithë ata që e quajnë veten shqiptarë nuk do ta çojnë kufomën time të tretet në tokën mëmë. Kam lënë menjanë edhe harxhimet e rrugës për trupin pa jetë dhe shumën për dy metra vend në Shqipëri”, - thuhet në testamentin e Konicës.***

Tituj të veprave

- ▶ *Ç'është liria*
- ▶ *Dr.Gjëlpëra*
- ▶ *Shqipëria si m'u duk*

Konica me fustanellë në Boston



A photograph of a library or study room. In the foreground, a large, open book lies flat on a wooden desk. To the left of the book, a laptop computer is open, its screen dark. The background is filled with tall wooden bookshelves packed with books. A lamp is visible on a shelf in the upper left, casting a warm glow. The overall atmosphere is quiet and scholarly.

Ju faleminderit
për
vëmendjen!